



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2021:197754

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06378136

Kom.Dh.Shk.II.nr. 1553/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit “Koninklije PHILIPS N.V.” me seli në High Tech Campus 5, 5656 AE, Eindhoven, Holandë, me numër regjistrimi 17001910, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit “MILI COMPANY” SH.P.K., me NUI: 810864737, me seli në Prishtinë, rruga “Lidhja e Pejës”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.1183/2022, të datës 24.05.2024, me datë 24.10.2024, mori këtë;

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit “MILI COMPANY” SH.P.K., me NUI: 810864737, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.1183/2022, i datës 24.05.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar KE.nr.1183/22 të datës 24.05.2024, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vepruar si gjykatë e shkallës së parë ka vendosur si në vijim:

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Koninklije PHILIPS N.V.” dhe Vërtetohet se i padituri “MILI COMPANY” SH.P.K., me importimin e 450 drita LED, ka shkelur markën tregtare të paditësit “PHILIPS”.
- II. I NDALOHET të paditurit “MILI COMPANY” SH.P.K., që të importoj mallrat që shkelin markën tregtare të paditësit “PHILIPS”.

- III. LEJOHET shkatërrimi i mallrave 450 drita LED, që shkelin markën tregtare të paditësit dhe OBIGOHET i padituri që nën mbikëqyrjen doganore të bëjë shkatërrimin e mallit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- IV. OBLIGOHET i padituri që të paguaj shpenzimet e transportit, ruajtjes dhe magazinimit të mallrave 450 drita LED, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.
- V. OBLIGOHET i padituri që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 1,610.00 € (një mijë e gjashtëqind e dhjetë euro), në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet në tërësi ankesa e të paditurit si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.1183/2022, të datës 24.05.2024, ashtu që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit “Koninklije Philips N.V” për mbrojtjen e markës tregtare dhe të detyrohet paditësi që t’ia kompensojë të paditurit shpenzimet e procedurës.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar paditësi.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194, 208 dhe 209 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Paditësi “Koninklije PHILIPS N.V.”, përmes të autorizuarit të tij, me datë 06.09.2021, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për shkeljen e markës tregtare kundër të paditurit “MILI COMPANY” SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri “MILI COMPANY” SH.P.K., ka shkelur markën tregtare të paditësit “Philips” me numër regjistrimi 019056, të i ndalohe të paditurit që në të ardhmen të importoj mallrat që shkelin markën tregtare të paditësit, të lejohet shkatërrimi i mallrave 450 drita LED, që shkelin markën tregtare të paditësit dhe të obligohet i padituri që nën mbikëqyrjen doganore të bëjë shkatërrimin e mallit, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, të obligohet i padituri që të paguaj shpenzimet e transportit, ruajtjes dhe magazinimit të mallrave 450 drita LED, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, të obligohet i padituri që paditësit t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar për shkak të dëmtimit të imazhit të markës tregtare, si dhe të obligohet i padituri që të paguaj shpenzimet e procedurës konstestimore. Në seancën e datës 15.02.2023, është tërhequr nga pika V e kërkesëpadiësë, përkatësisht nga kërkesa për kompensimin e dëmit të shkaktuar për shkak të dëmtimit të imazhit të markës tregtare.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave e ka aprovuar në tërsi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit pasi që ka ardhur në përfundim se sepse fjala dhe shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit. Në arsyet e aktgjykimit të atakuar, Dhomat e Shkallës së Parë kanë konkluduar se fakti se mallrat janë origjinale ose jo, nuk përbën fakt relevant për vlerësimin e shkeljes së markës tregtare. Andaj, bazuar në dispozitat e Nenit 8 të LMT vetëm fakti i importimit dhe vendosjes në treg të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin të bartësit të së drejtës së markës tregtare të regjistruar, përbën shkelje të markës tregtare.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, para. 2, nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e shkallës së dytë pas vlerësimit të pretendimit ankimor të autorizuarit të palës së paditur, në lidhje me origjinalitetin e mallit, vlerësoi se qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në lidhje me origjinalitetin apo jo të mallrave të importuara nuk përbën një fakt relevant për vlerësimin e shkeljes së markës tregtare, dhe sipas të cilës vetëm fakti i importimit dhe vendosjes në treg të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin e bartësit të së drejtës së markës tregtare të regjistruar, përbën shkelje të markës tregtare.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, ngase bazuar në provat përkatëse të lëndës ka vlerësuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të të paditurit lidhur me konstatimin e gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë për faktin se në mënyrë të pakontestueshme është vërtetuar se i padituri në mënyrë të paautorizuar ka bërë futjen e mallit në fjalë në territorin e Republikës së Kosovës, i cili mall ka përmbajtur në vete markën tregtare të paditësit të regjistruar në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë e këtij veprimi, i padituri ka shkelur të drejtën e markës tregtare të paditësit.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë i vlerësoi si të paqëndrueshme pretendimet ankimore të autorizuarit të të paditurit lidhur me gjendjen faktike respektivisht lidhur me importin e mallrave për të cilat e paditura pretendon se nuk janë mallra false. Sipas vlerësimit të kolegjit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar me rastin e vërtetimit të shkeljes së markës tregtare duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike kur ka konstatuar se shenja që është përdorur në produktet e importuara të paditurit është identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e importuara të paditurit nuk ka asnjë dyshim se mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për

produktet e paditësit. Në këtë drejtim me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se opiniononi i ekspertit nuk është me ndikim në vendosjen e fakteve vendimtare, si rrjedhojë e së cilës nuk kemi të bëjmë me shkelje eventuale të gjendjes faktike apo procedurale të cilat do të kishin ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare (LMT), i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale vlerësojnë se shkelja e markës tregtare mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëra prej të drejtave të pronarit të markës tregtare të përcaktuar me Nenin 8 të LMT-së. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar. Sipas Nenit 8, para. 1, nën-para. 1.2 i LMT-së, pronari i një marke të regjistruar nuk ka nevojë të vërtetojë konfuzionin që faktikisht është krijuar nga përdorimi i markës identike ose të ngjashme, por vetëm mundësinë e krijimit të një konfuzioni tek konsumatorët. Në rastin konkret, e bazuar në dispozitat e sipërcituara vetëm fakti i importimit dhe vendosjes në treg të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin e bartësit të së drejtës së markës tregtare të regjistruar, përbën shkelje të mjaftueshme të markës tregtare.

Për më tepër produktet e paditësit që përmbajnë markën tregtare të tij, janë produkte të mirënjohura që kanë përdorim të gjerë dhe që përdoren nga qytetari i rëndomtë, andaj edhe rrethi i konsumatorëve është i gjerë dhe lehtësisht mund të mos e dallojnë diferencën ndërmjet mallrave të paditësit dhe mallrave kontestuese të të paditurit të importuara pa autorizim.

Nga të lartcekurat rezulton se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale me rastin e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar me ankesë.

Kolegji i vlerësoi pretendimet ankimore lidhur me shpenzimet e procedurës, sa i përket kontestimit të elementit të huaj në procedurë, mirëpo vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë që në kontestet ku pala ka seli në shtetin e huaj, ky kontest konsiderohet me element të huaj dhe paditëses i takon shpërblimi sipas tarifës së OAK.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovojnë edhe Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale .

Numri i lëndës: 2021:197754
Datë: 31.10.2024
Numri i dokumentit: 06378136

Nga sa u tha më lartë, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallë së Dytë, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 para. 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë,
Kom.Dh.Shk.II.nr. 1553/2024, me datë 24.10.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova